

## KLSH AUDITON 22 PËRQIND MË SHUMË SUBJEKTE TË BUXHETIT QENDROR

nga Manjola NAÇO – Drejtore Departamenti,

botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 23 janar 2014.



Këto ditë, zhvilloi analizën vjetore Departamenti i Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm. U analizua veprimtaria e Departamentit, duke u përqendruar kryesisht në arritjet e punës audituese të realizuar në përputhje me programin e vjetor të auditimit të miratuar për vitin 2013, treguesit lidhur jo vetëm me numrin e auditimeve por edhe me llojin e rekomandimeve të dhëna sipas Institucioneve duke gjykuar edhe për impaktin që kanë sjellë këto auditime në mirëadministrimin e fondeve publike dhe në mirëqeverisjen në përgjithësi. Analiza u ndal edhe në nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara, të cilat janë me të larta krahasuar me vitin 2012. Analiza i kushtoi vëmendje edhe punës së audituesve të departamentit në drejtim të analizës dhe shqyrtimit të cilësisë së auditimeve, zbatimin e kodit etik si dhe vlerësimin e veprimtarisë së secilit auditues, pjesëmarrje në trajnime etj.

### **Treguesit e arritur**

Në vijimësi u paraqitën treguesit e realizuar si më poshtë: për vitin 2013 realizimi i planit të auditimeve paraqitet në masën 122 %. Kanë përfunduar dhe janë evaduar materialet e auditimit në 39 subjekte, të cilat sipas llojit të auditimit të kryer, në:

- 25 subjekte      auditimet janë kryer të përputhshmërisë (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare) të aktivitetit ekonomik dhe financiar;
- 12 subjekte      janë kryer auditime financiare të rregullshmërisë dhe ligjshmërisë sipas praktikave të NAO së Britanisë së Madhe;
- 2 auditime      kanë      qenë      tematike, e përkatësisht për zbatimin

rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në kontrollet e kryera në vitin 2012 dhe 2013.

Gjatë punës audituese të vitit 2013 janë dhënë nga Departamenti gjithsej 779 rekomandime, nga të cilat:

- a. Për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore janë bërë 67 rekomandime;
- b. Për përmirësimin e gjendjes dhe të veprimtarisë së institucioneve të audituara janë rekomanduar 465 masa organizative;
- c. Për zhdëmtimin e dëmeve ekonomike të shkaktuara nga persona dhe subjekte private kontraktore, është konstatuar një dëm ekonomi në 116 raste në shumën 12,190,484 mijë lekë dhe është kërkuar nxjerrja e titujve ekzekutivë dhe ndjekja në rrugë ligjore për 115 raste në vlerën 11,177,884 mijë lekë. Nga vlera e dëmit ekonomik të konstatuar gjatë këtij viti, janë pranuar nga titullarët dhe kanë nisur procedurat për kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht në 33 raste në shumën 55,032 mijë lekë, priten përgjigjet nga subjektet e për rrjedhojë konsiderohen në proces zbatimi për 33 raste në shumën 11,935,131 mijë lekë dhe nuk kanë kthyer përgjigje ose në përgjigjet e titullarëve nuk shprehen për nisjen e procedurave ligjore për zhdëmtimin e tyre, e për rrjedhojë i konsiderojmë të pa zbatuara 49 raste në shumën 200,321 mijë lekë;
- d. Janë rekomanduar 95 masa disiplinore, nga këto është kërkuar largimi nga shërbimi civil, largimi nga puna apo ndërprerja e kontratës së punës për 31 zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të lartë;
- e. Janë rekomanduar 36 masa administrative.

***Cilësi në auditim***

Analiza tregoi se gjatë vitit nuk ka patur vetëm rritje në sasi të gjetjeve apo rekomandimeve të bëra por kjo është shoqëruar me një punë më cilësore në argumentimin e masave të propozuara në raport me gjetjet nga auditimi, në përpjekje për arritjen e objektivit për përcaktimin e drejtë të masave të propozuara ndaj administratës publike.

Gjatë vitit, krahas impenjimeve në auditim është ndjekur me përparësi programi i trajnimeve të organizuar nga Sektori i Trajnimeve në KLSH. Gjithsej janë kryer 507 ditë trajnimi dhe mesatarja e departamentit është 22 ditë trajnimi në vit për çdo

auditues në fusha të ndryshme. Janë realizuar aktivitete për rritjen e njohurive të stafit për të mundësuar permbushjen e detyrimit të KLSH për të dhënë një opinion për raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të shtetit, të sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm, vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare. U vlerësuan arritje pozitive në drejtim të zbatimit të kodit të etikës, si dhe u vlerësuan artikujt e shkruara në shtypin e përditshëm dhe në Revistën “Auditimi Publik” të KLSH gjatë vitit 2013. Ka arritur në rritje kontributi në thellimin e rolit të institucionit në luftën kundër korrupsionit në përpjekjet e KLSH, për arritjen e objektivit mbi ndikimin dhe këmbënguljen për krijimin e një mjedisi parandalues kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit dhe rritjen e rolit të KLSH në luftën kundër korrupsionit bazuar në standardet e INTOSAI dhe standardin ISSAI 1240.

Duke patur si një drejtim të ri të punës së KLSH pjesëmarrjen e publikut dhe përgjigjes në kohë të ndjeshmërisë qytetare gjatë vitit 2013 janë trajtuar gjithashtu brenda afateve, 79 ankesa nga qytetarët, pa cënuar punën e përditshme. Krahas arritjeve dhe dobësive të konstatuara në punën e departamentit, u vu theksi në kontributin më pozitiv në arritjen e objektivave.

Kryetari i KLSH-së, Bujart Leskaj, vuri në dukje arritjet pozitive të Departamentit të Buxhetit Qendror, i cili ka pasur prodhimtari pozitive, pavarësisht ndryshimeve. Ai theksoi se “në këto dy vite në punën tonë u orientuam tek parimet themelore të auditimit, Deklarata e Limës, Meksikos, standardet e përgjithshme dhe standardet e fushës. Kemi publikuar gjithashtu Udhëzuesin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të cilët duhet të jenë udhërrefyesit tuaj në punën e auditimit. Duke venë në përdorim këto materiale themelore për punën e audituesit, ju do të jeni në gjendje që shumë shpejt të rrisni nivelin analitik të raporteve dhe të lehtësoni strukturën e tyre. Në këtë kontekst është i nevojshme përvetësimi i koncepteve shkencore të përfshira në pesë numrat e revistës sonë shkencore "Auditimi Publik", duke i dhënë vlerë të shtuar punës audituese si edhe njohurive tuaja personale dhe shkencore”.

### ***Puna në të ardhmen***

Gjatë diskutimeve të shumta, e morën fjalën Kryeaudituesi i Departamentit, z. Muhamed Kavaja, si dhe auditues të tjerë me përvojë si z. Beleshi, znj. Piranjani, të cilët në vija të përgjithshme diskutuan pikat e mëposhtme:

## **AUDITUESIT E KLSH-së NË SHTYPIN E PËRDITSHËM**

---

- nevoja për shtimin e burimeve njerëzore në dispozicion të Departamentit;
- nevoja për lehtësimin e volumit të raporteve të auditimit;
- unifikimi i rekomandimeve dhe i terminologjisë të përdorur;
- nevoja për trajnime praktike që lidhen me kontekstin real të punës së përditshme audituese;
- bërja e materialeve audituese sa më atraktive dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

Në fund, kryetari Leskaj ju drejtua audituesve të departamentit më këshillën se pritshmëria institucionale në lidhje me arritjet e gjithë secilit është drejtpërdrejtë e lidhur me trajtimin që audituesit i japin observacioneve të subjekteve të audituara. Pra trajtimi i këtyre observacioneve me ndërgjegjshmëri dhe paanshmëri nga ana e tyre është detyrë e çdo audituesi të ndershëm dhe me integritet. Z. Leskaj përfundoi duke u shprehur se: “Vijat e bardha të punës sonë, të cilat duhet të na udhëheqin gjithmonë, janë Kushtetuta, Ligji, Standardet dhe praktikat më të mira të partnerëve tanë ndërkombëtarë”.